

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 29.04.2026
PRIMLJENO:
Nr.No.Pr. 02/124



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -II- (dytë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës.

Mbledhja u mbajt, më datë: 30.03.2026, duke filluar nga ora: 09:10.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Malishevë, Fatmir Ademaj. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: 18 anëtarë të Kuvendit Komunal, Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport-Teuta Miftari, Drejtori për Buxhet dhe Financa-Blerim Thaqi, Drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm-Arbër Kastrati, Drejtoresha për Pronë-Mirëlinda Gashi, Drejtori i Inspektoriatit-Jakup Gashi dhe përfaqësues nga Zyra për Informim.

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -I-(parë) inauguruese, e mbajtur me datë:03.12.2025, mbledhjes së -I- (parë) të jashtëzakonshme, e mbajtur me datë: 31.12.2025, procesverbalit të mbledhjes së -I- (parë) të rregullt, e mbajtur me datë:12.03.2026.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2026.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/451, datë: 03.03.2026, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për miratim të listës së pronave të paluajtshme të Komunës së Malishevës, për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026.
4. Shqyrtimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar- dhjetor 2025.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/459, datë: 04.03.2026, për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të KKSBB-së për Komunën e Malishevës.
6. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve "Stacioni i Autobusëve" SH.A. Malishevë
7. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve "EKO-Regjioni" SH.A. Prizren, njësia në Malishevë
8. Formimi i Komiteteve jo obligative.
9. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale.
10. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/46, datë: 10.03.2025, për lejimin e kompensimit të tokës të marra në ngastrat 991 dhe 992 për nevojat e zgjerimit të rrugës "Hamdi Berisha" në Malishevë.
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/109, datë: 29.04.2025, për iniciimin e procedurës për këmbim të pasurisë.
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/77, datë: 19.03.2026 për subvencionim të NPK Stacioni i Autobusëve SH.A. Malishevë.
13. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhë në mbledhjen e II- (dytë) të rregullt lus sekretarin që të bëjë numrimin e votave se a kemi kourum për mbarvajtje të seancës. 18 jemi të pranishëm kemi kourum dhe mund të vazhdojmë me mbarëvajtje të seancës.

Para se të kalojmë me rend të ditës e hapi debatin jashtë rendit të ditës.

Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtarë nga LVV): Përshëndetje për të gjithë!

Amrushit ja kam bërë disa pyetje në mbledhjen e kaluar, dhe nuk kam marrë përgjigje as në seanc dhe as në email. Kështu që po ja përsëriti prapë, dhe besoj që vjenë gjatë seancës dhe na përgjigjet.

Janë mbi 30 punëtor të QKMF-së që nuk kanë marrë paga qe 6 muaj, a kanë të angazhur një kontrat me një operatorë tjetër ekonomik që ka Komuna marrëveshje? Përse nuk paguhen dhe përse nuk i shpallë mbi 15 vende të tjera të punës të cilat janë të lira në QKMF? Po bëhet fjalë për mjek, për infermier dhe puntorë të tjerë të stafit ndihms. Amrushit po besoj e ka kaluar këtë muajin e mjalitit me këto foto, vizita, ka kaluar fushata duhet me u ul me punu me i zgjidh problemet.

Qështja tjetër është mos furnizimi i laboratorit me material, prej shumë qytetarëve kamë marrë shkresë që detyrohen me dalë për analiza më të thjeshta në laboratore private. Ne kur e marrim në fillim të vitit projekin buxhetor, buxheti i ndar për shëndetësi i mbulojmë dhe shërbimet e analizave.

Një qështje tjetër nuk qenka Avdia këtu së bashku me Skenden kemi marrë pjesë në një takim me Kryetarin e fshatit të bashkësis lokale Lladroc-Senik aty janë ngrit shumë qështje besoj që tani

vetëm i ka marrë Kryetari dhe drejtori i Urbanizmit shkresat zyrtare, janë tri kërkesa. Dua të di a i ka pranuar dhe a janë duke u trajtuar?

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Faleminderit Vetoni!
Urdhëro, Remzi Hoti!

Remzi Hoti (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Desha ta falenderoj Vetonin, sepse po i rrika shumë gati Amrushit, është mirë me marrë pjesë te shtëpia e shëndetit në Kijevë me i pa mrekullit të cilat janë duke u bërë në shëndetësi.

Ka pyetur shumë shpesh sa ka borgje Komuna e Malishevës, mirë ka qenë me pyet Vetoni qeverien a e dinë se ku i bie Malisheva, me u marrë pak me atë pjesë dhe me na ndihmu ndonjë gjë. Nuk është zi siç po thotë Vetoni, ka shumë të mira në Komunën e Malishevës dhe ende janë duke punuar qdo ditë. Amrushit është njëri prej Drejtorëve më të mirë unë që e shoh.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Veton Zogaj, kundër replik!

Veton Zogaj (anëtarë nga LVV): Unë personale me Amrushit nuk kamë asgjë, secilin punim që e bënë qeverisja Komonale ne e mbështesim dhe me votë siç është renovimi i QMF-së në Kijevë. Ne jemi asambleistë në Kuvendin Komunal në Malishevë pak na takon me u marrë atje, ka kush mirret me ato punë. Me nis me ta tregu listen sa ka investu qeverisja qendrore në Malishevë besoj na zën nata këtu.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Unë vlersoj që dhe Qeveria Qendrore dhe qeveria Lokale e kanë për obligim të kujdesen për qytetarët, dhe të ju shërbejnë qytetarëve me gjitha kapacitetet e tyre. Nuk janë investime partiake as në nivel lokal dhe as në nivel qendror, të gjithë ne që bartim përgjegjësi jemi të obliguar të punojmë për qytetarët e Komunës së Malishevës, këtë e ceka në cilësinë e Kryesuesit të asamblesë Komonale.

Urdhëro, Drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaçi!

Drejtori për Buxhet dhe Financa, Blerim Thaçi: Dua ta njoftoj Vetonin që e bëri pyetjen për pagat të cilat nuk i kanë marrë punëtorët e shëndetësis, dy pagat i kanë marrë dhe e kanë vetëm edhe Marsin pa e marrë, besoj shumë shpejtë kompletohet dhe kjo pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Kalojmë në Rendin e Ditës, a ka dikush për rend të ditës? Nëse nuk ka, ashtu siç jemi dakorduar dhe në KPF kanë qenë dy kërkesa nga zyra e Kryetarit që kanë qenë rekomandim nga MAPL unë do të i lexoj të dya që do të jenë pjesë e

rendit të ditës të kësaj seances.

Kërkesa e parë është:

Kërkesë për shqyrtim dhe miratim të ndarjes së sipërfaqes prej 4/ha, nga sipërfaqja e tërësishme prej 166118m² për përkufizimin e lokacionit të Deponisë për Mbeturina Inerte, të përcaktuar sipas vendimit të Kuvendit nr.02/219, datë: 05.05.2022, si dhe 4/ha për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve afariste, nga njësia kadastrale p-72316001- 02053-0, në vendin e quajtur Gajrak-Rruga, me kultur tokë pyjore Mal i klasit 6, në pronësi të KK Malishevës.

Kërkesa e dytë është:

Propozim për shqyrtim të mëtejme të kërkesës nr. 01/35, dt.21.03.2025, të parashtruar nga DHF-Company "sh.p.k, ne numër uni indentifikues (NUI) 810746670, me seli në Pejë, rruga UQK-së, sipas Autorizimit që e përfaqëson Avokat Qendrim Arifaj, nga Arifaj dhe Partner's, Laë Firm L.L.C, me numër unik identifikues 812060862, me seli në Prishtinë, rr.Tring Smajli" nr.10/6. Këto kërkesa vendosen te pika 13 dhe Pika 14 në rend të ditës. Pasi që nuk patë për rend të ditës, kush është për këtë rend të ditës me propozimet të cilat i bëra?

Për: 16,

Kundër: 0

Abstenime: 6

Kalon Rendi i dites së bashku me propozimet.

Pika e 1.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit te mbledhjes së -I- (parë) inauguruese, e mbajtur me datë: 03.12.2025, mbledhjes së -I- (parë) të jashtëzakonshme, e mbajtur me datë: 31.12.2025, procesverbalit të mbledhjes së -I- (parë) të rregullt të mbajtur me datë: 12.03.2026.

A ka dikush për trajtim për këto procesverbale? Nëse nuk ka,

Kush është për miratimin e këtyre procesverbalëve?

Unanimisht për!

Pika e 2.

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2026.

Ne siç e dimë e kemi formuar një Komision ku e ka kryer punën e vetë është takuar dhe ka rekomanduar planin vjetor të punës së Kuvendit komunal. Gjithë ashtu për punën e Komisionit kemi pasur takim dhe me drejtorë komunal për ti harmonizuar qëndrimet dhe kërkesat e Drejtorëve për punën një vjeqare që mund të kenë si interpretim, apo gjatë mbledhjeve të vazhdueshme të asamblesë Komunale. Planin e keni ju lus të diskutojmë për planin dhe pastaj ta miratojmë. Hapi debatin për anëtarë të asamblesë.

Zyrtari ligjor- Muharrem Morina: Për hirë të korrektësis 15 vota kenë për te rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Po e korigjojmë 15 vota kanë qenë për te rendi i ditës. Urgjëro, Veton!

Veton Zogaj (anëtarë nga LVV): Plani qenka shumë i njejt me planin e vitit të kaluar, vetëm te kjo pika në muajin Maj shqyrtimi dhe miratimi i raportit për ndryshim plotësimin e orarit të punës për biznese afariste kjo kishte qenë mirë me u sjellë më herët. Dhe shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Kuvendit për vitin 2025, zakonisht ka qenë në Janar përse ka ardhë në muajin Prill?

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Hafir Rexha!

Hafir Rexha (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Pëshëndetje të gjithë!
Në emër të grupit parlamentar të Nismës Socialdemokratike i japim mbështetje kësaj pike.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtar nga PDK): Përsëndetje për të gjithë!
Ne si grup i PDK-së e mbështesim planin e punës dhe shpresoj që ky plan i punës të respektohet gjatë tërë vitit.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Fitim Shala!

Fitim Shala (anëtarë nga LDK): Përsëndetje për të gjithë!
Në emër të grupit të LDK-së e mbështesim këtë plan të punës së Kuvendit Komunal të Malishevës për vitin 2026.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Plotësim i vogel ka qenë në Muajin Prill ku do të fillohet procedura për harta zonale për PZHKN për arsye që rekomandimet të cilat i kemi marrë duhet të fillojnë që këtë vitë dhe procedura me u zhvillu në 2027. Kështu që të gjitha procedurat që fillojnë, me fillu nga Prilli i vitit 2026. Në mbledhjen e parë do të fillojnë procedurat për këto dy institucione që janë të rëndësishme për zhvillimin e Komunës së Malishevës.
Nëse nuk ka ndonjë gjë tjetër, kush është për planin e punës me rekomandimet të cilat u cekën?
Unanimisht për.

Pika e 3.

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/451, datë: 03.03.2026, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për miratim të listës së pronave të paluajtshme të Komunës së Malishevës, për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026. Pas kalimit në KPF rekomandohet për asamble Komunale hapi debatin për anëtarë të asamblesë komunale për trajtim të kësaj pike të rëndësishme.

Urdhëro, Bashkim Krasniqi!

Bashkim Krasniqi (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Përshëndetje për të gjithë!

Këtë kërkesë kemi pasur dhe në mbledhjen e kaluar. Është pikë e cila është e parapame qdo vitë Kuvendet Komunale ta miratojnë listën e pronave, është një lloj planifikimi. Kjo është hyp në fuqi me miratimin e ligjit në vitin 2019, mirëpo nuk ka mundur të fillohet me miratim të listës në vitin 2020 për arsye të pandemis, kemi filluar në vitin 2021 që ka qenë një listë afër 50 e diqka prona me një numër më të vogël, dhe ka shkuar duke u ndryshuar çdo vitë me 150 prona. Dhe tani kemi një listë me 244 prona, është ndryshu qdo vitë me shikimin e praktikave në Komuna të tjera. Është mirë ta kemi parasysh që nuk kemi të bëjmë me dhënie në shfrytëzim të këtyre pronave, është një planifikim Komunal që është obligativ nëse komuna ka interesë ndonjëherë prej këtyre pronave të cilat janë në këtë listë me dhënë në shfrytëzim gjatë këtij viti. Fakti që miratohet kjo listë sot nuk do të thotë që këto prona jepen në shfrytëzim me këtë miratim që e bëjmë ne. Është mirë mos me paraqit kështu të opinionit që ne po i dhëjmë në shfrytëzim të gjitha këto prona, nuk mundet me i dhënë askush në shfrytëzim 244 prona menjëher dhe aq më pak pa e paraqit asnjë kriter për secilën pronë që ndodhet në këtë listë. Ligji e thotë që për secilën pronë, secilin vendim duhet të ketë komision të veçantë kështu që kur të formohet Komisioni votohet prona e veçantë caktohen kriteret dhe qëllimin për qfarë jepet në shfrytëzim ajo pronë, atëherë kemi të bëjmë me dhënie në shfrytëzim. Për momentin është vetëm një planifikim sikur plani i punës së Kuvendit që u miratua është diqka që duhet bërë. Në emër të anëtarëve të grupit të Nismës ne e mbështesim dhe do të votojmë pro kësaj liste.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, nga PDK Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtarë nga PDK): Përshëndetje për të gjithë!

Sot në pikën e tretë për kërkesën që me i dhënë në shfrytëzim pronat e Komunës së Malishevës për vitin 2026, ne si grup e kemi analizuar listen dhe janë bërë disa selektime të pronave. Dëgjova Bashkimin që e cekti që në vazhdimësi lista e pronave vazhdon të rritet dhe e kuptojmë mënyrën se si vazhdon të rritet por ne kemi vërejtje për disa prona. Prona e parë është me numër të njësisë kadastrale P-72310047-01046-166 mendoj që kjo pronë duhet të largohet nga lista e dhënies në shfrytëzim sepse është në qendër të qytetit të Malishevës. Kemi njësinë kadastrale P-72310047-00894-25 e cila dhe kjo është në qendër të qytetit të Malishevës, këtu shohim në vazhdimësi selektime të pronave pastaj kemi në Dragobil njësinë kadastrale P-723125-00223-672, në Dragobil njësinë tjetër kadastrale P-723125-00223-668 janë dhe një numër i pronave që ne si

PDK këto prona duhet të vijnë me një plan të veçant nëse dëshirojna me u fut në listën për me u dhënë në shfrytëzim. Për këtë arsye ne nuk e mbështesim listen e pronave. Prandaj këto tippet e pronave të cilat janë me ndikim në qytetin e Malishevës direk dhe që do të politizohen në të ardhmen ne propozojmë që të largohen, pastaj ta mbështesim këtë listë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtarë nga LVV): Unë dhe në KPF i kamë ngrit disa shqetësime dhe kam mendu që të paktën do të mirren parasysh. Ne e dimë që është obligim ligjor me miratu listen, por nuk është obligim ligjor me i fut të gjitha pronat publike. Siq e kamë parë keni bërë një selektim prej numrit 1 deri 45 ka bërë lista të veqanta të pronave të paluajtshme. Dhe pastaj vazhdon pjesa tjetër lista e përgjithshme me prona të paluajtshme në territorin e Komunës së Malishevës. Unë krejt qka kamë kërkuar është që në kuadër të kësaj liste të veçant nëse ka interes prej kompanive të ndryshme, investitorëve të ndryshëm ne e bëjmë një listë nuk është e domosdoshme me i dhënë 250 prona dhe pastaj mos të ketë hamendsime nga qytetarët. Ne mundemi me bërë një listë më të ngusht të pronave me interes për qytetarët të cilat mundemi me i dhënë në shfrytëzim investitorëve të ndryshëm, jo me i fut disa prona psh në fshatin Lladroc në bjeshkë nuk e di qfarë interesi ka nëse jipet me qera, nuk e di pse me e dhënë atë pronë në shfrytëzim. Ne nuk e votojmë pro këtë kërkesë të Kryetarit.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Përshëndetje për të gjithë!

Unë erdha pakë vonë por po e shoh që jemi te pika e listës së pronave.

Ju të gjithë e dini që ky është një obligim ligjor me i votu të gjitha pronat të cilat janë të lira dhe që presupozohet me i dhënë në shfrytëzim. Nga dy kolegët e mi që i dëgjova, ne nuk mundemi me dit në cilen pronë ka me pasë interes nesor dikush për me investu. Andaj për ne është obligim të gjitha pronat të cilat janë prona të Komunës dhe ligjërisht mund të jepen në shfrytëzim ne me i votu në këtë listë. Në momentin pasi i kemi këto prona të gatshme për dhënie në shfrytëzim, nesër mundet me ardhë një i interesuar te ajo prona që e ceki Vetoni në Lladroc në bjeshkë dëshiron me bërë ndonjë panel djellor apo dëshiron të bëjë diqka, ne e shohim që është në interes të Komunës së Malishevës dhe mund të ja dhëjmë në shfrytëzim. Qfarë problemi ka nëse të gjitha pronat të cilat i kemi me i futë në këtë listë. Ne nuk po e dhëjmë në shfrytëzim asnjë pronë sot ne po e plotësojmë një obligim ligjor që të gjitha pronat të cilat janë prona të Komunës së Malishevës të lira për dhënie në shfrytëzim, edhe nëse asnjë nuk e dhëjmë në shfrytëzim ne asgjë keq nuk kemi bërë që i kemi futur në këtë listë. Kamë parë që disa këtë lloj të listen ë parim pronat të cilat janë të lira janë interpretu si dhënie në shfrytëzim të këtyre pronave. Po tenton Komuna me i dhënë në shfrytëzim të gjitha këto prona, ne nuk guxojmë të bëjmë kesi lojra politike me u lënë me u keqinterpretu ku të gjithë e dimë saktë se qysh është. Për mua është jo korrekte politikisht dhe jo korrekte moralisht me dalë me dhënë një status në facebook dhe me

thënë Komuna e Malishevës po tenton në mënyr të jashtëligjshme të gjitha këto prona me i dhënë në shfrytëzim menjëher. Ne si grup i Nismës votojmë këtë listë sepse është obligim ligjor me u votu kjo listë, ne si grup i Nismës kemi interes që pronat të e Komunës së Malishevës të cilat janë të lira për dhënie në shfrytëzim me i dhënë në shfrytëzim atë her kur e shohim që është interes i Komunës së Malishevës, ja rrisim vlerën kësaj prone, rrisim numrin e të punsuarit, sjellim investime. Kjo është mënyra e vetme që Komunën tonë mundemi me zhvillu ekonomikisht.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Veton Zogaj replik!

Veton Zogaj (anëtar nga LVV): Ne këtë listë e votojmë qdo herë, a e kemi për obligim me publiku qdo her apo këto prona që votohen sot kjo listë a qëndron e publikume si pronë dhe vetëm pronat e reja kur të vijnë në vitin tjetër, sepse kamë parë prona nga viti 2022. Qështja tjetër Halil lexoje saktë qa kamë shenuar nuk kamë thënë që dëshirojnë me i dhënë në shfrytëzim por kamë thënë me qenë saktë në përputhje me ligjin, jo me u kalu në Kuvend pa kaluar në KPF. Kështu ka qenë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Demir Bajra!

Demir Bajra (anëtarë nga PDK): Përshëndetje për të gjithë!

Unë sa i përket kësaj pike të rendit të ditës do të jem kundër sepse duke u bazuar në fshatin Panorc prej nga vi i ndëgjova parafolësit dhe Halili po na dhëjnë filozofi se qka mendojmë dhe qka postojmë në rrjetet sociale. Unë besoj që Nisma Socialdemokrate mandati i 4 qeverisje po më duket që i ka shtjerrë të gjitha pasurit e paluajtshme në qendrën e Malishevës dhe tani i ka mbetë me na sjellë konkluzion dhe nëpër fshatra. Po e shoh një pronë në mesë të arave në Panorc nuk ka rrugë po të kishte rrugë kishte me qenë më ndryshe. Kemi njerëz në Panorc që kanë ble pasuri për 100 vite dhe sot dalin zyrtarisht e thojnë këtë gjë. Kishte qenë mirë me i bërë në mënyr vizuele cilat janë ato parcella që ne duhet me i votu dhe cili është interesi i njerëzve me i marrë në shfrytëzim. Unë kërkoj nga oragnet kompetente që ta shqyrtojnë mirë këtë qështje kush e ka përpunuar këtë dhe i ka bërë këto seleksionime jo njerëzore.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, replik Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Nëse ka diku ndonjë shtëpi që ka ndërto shtëpi në pronë të Komunës atëher me atë po u duket me u marrë. Nëse është një pronë që figuron që është pronë e Komunës së Malishevës mua nuk më intereson a është e lirë apo e nxënë ajo pronë. Në momentin që është pronë e Komunës së Malishevës për mua si anëtarë i Kuvendit të Komunës së Malishevës është ozurpim, pa i ditë fare rrethanat tjera se si janë.

Kështu që nëse dikuj ja ka ozurpu Komuna pronën e tijë dhe e ka qit në emër të Komunës ai sigurisht që ish marrë me këtë qështje dhe e kish fitu të drejtën e tijë me anë të gjykatës. Po përderisa ajo pronë është pronë në emër të Komunës së Malishevës atëher është obligim me qenë në këtë listë të pronave për dhënie në shfrytëzim.

Dem unë këtu jap qfarë të dua filozofi, kimi apo politik sepse këtë të drejtë ma kanë dhënë qytetarët e Komunës së Malishevës edhe ti jep najë gjë nëse ke për të dhënë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Hafir Rexha!

Hafir Rexha (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Kuvendi është për me bërë politikë sepse politika na ka sjellë këtu dhe na përfaqësojmë politika. Listen e pronave sa e di unë është obligim ligjorë e sqarojë në mënyrën më të mirë të mundshme Bashkim Krasniqi i Nismës Socialdemokrate! Këto nuk janë prona që Komuna po i jep në shfrytëzim, nëse ka raste që potencojë Demir Bajra kjo është shumë normale dhe evidente janë Drejtoritë përkatëse. Nëqoftëse jamë unë ai i cili posedojë pronën qe 100 vite të ja gjejë zanafillin, historiatin si ka ardhë është obligim i imi si qytetarë për me e ditë pronën time. Por në qoftëse prona na figuron që është e Komunës atëher edhe me qenë e babit timë duhet të i kthehet Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Në proces të përgjithshëm LDK-ja vlerëson që në Podujevë është e gabuar dhënia e pronës në shfrytëzim.

VV-ja në Ferizaj thotë të njëjtën gjë. Kështu që të gjitha Komunat ballafaqohen me të njëjtën temë lista e pronave është obligim ligjor i asamblesë me kalu qdo vitë. Politikë mundemi me bërë sidomos në aspektin e buxhetit, infrastrukturës dhe shumë tema por janë disa të cilat duhet të i trajtojmë në të njëjtën situatë sepse kemi obligim ligjor që të ju mundësojmë bizneseve apo investitorëve që të kenë qasje në shfrytëzim të pronave.

Urdhëro, Imran!

Imran Xhyliqi (anëtarë nga PDK): Ne si PDK e kundërshtojmë këtë listë për arsye se janë disa prona të cilat kanë interes më të madhë sesa disa prona në fshatra. Nëse dëshironi ne jau cekim 8 prona, ju largoni këto prej liste që i keni vendos me qëllim për privatizim. Ne e dimë se si ndodhë privatizimi në Malishevë sepse e kemi parë më herët.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Duhet me të ndërpre sepse jamë Kryesuesi i Asamblesë dhe nuk bëjmë privatizim të institucionit. Nuk të lejoj me vazhdu në komunikim pa bazë ligjore në interpretime të gabuara. Kërkoj nga grupi PDK të mos lejojë të bëhen kësi lloj gabime.

Imran Xhyliqi (anëtarë nga PDK): Nëse jipet për 99 vite qfarë i bjen kjo Kryesues? Janë 8 pika të cilat janë me interes personal jo të një individit por interes personal të subjektit politik të dhënies në shfrytëzim për me pas përfitime të subjektit. Këto 8 pika nëse i largoni ne do ta mbështesim do ta votojmë. Sa i përket moralit Halil secili e kallxon moralin e vetë nuk ka nevojë askush me na kallxu për moral, moral kemi secili.

U cekën pika të veqanta dua të ju ceki vetëm dy raste te prona e cila jepet në shfrytëzim e cila është te pazari i vjetër. Para tri viteve është blerë tokë aty dhe është mbi ndërtu 4 katë ju keni qenë në qeverisje ti ke qenë në asamble përse nuk ke bërë zë kur e dinë që nuk është e ligjshme. Aty është për m² e cila është dhënë në shfrytëzim mbas luftes aty është mbindërtuar 4 katë. Në atë treg të gjitha pronat janë të mbi ndërtuara të cilat e kanë dhe nga një katë të ndërtuar që shumica e dini dhe ju se kush janë. Nëse i largoni këto prona të cilat krijojnë konflikte ne po ju votojmë. Nëse dëshironi ne ju dhëjmë propozimin tonë me këto 8 prona dhe nëse i largoni ne e votojmë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Po e kam dhe problem me repliku kur ka probleme bazike me kuptimin e koncepteve të thjeshta tani kur ka problem me kuptimin e koncepteve të thjeshta nuk e kupton dhe as në cilin koncept është duke u përdor termi e pamoralshme ose e moralshme. As nuk kam se si me repliku kur nuk e ke të qartë qka do të thot privatizim dhe qka dhënie në shfrytëzim afatë shkurtë apo afatë gjatë. Pastaj e ke problem me kuptu se qka është duke u bërë te pazari i vjetër dhe i riu. Është e drejta ime me potencu qka dua unë qysh është e drejta dhe e jotja me potencu moral dhe qka do që ki mundësi.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Nëse nuk ka askush për deklaram nga anëtarët e asamblesë komunale, ftojë zyrtarin ligjor për kërkesën e Vetonit.

Muharrem Morina (zyrtar ligjor): Veton ne atë ditë në KPF e kemi sqaruar, është e vërtet që jemi dakorduar që listen e veqantë me shoqëru me qertifikata të pronës dhe një kopje të planit. Mirëpo për fatë të keqë nuk kemi mundur me i nxerr në aparatin kadastral. Ndërsa sa i përket listës së pronave që duhet me u publiku qdo vitë, nëse ka ndonjë ide. Ligji e thot që listen e pronave Kuvendi komunal duhet ta miratojë jo më larg se 31.12 na i kemi arsyet pse ministria e pushtetit lokal ka kërku dhe i ka dhënë afatë shtesë, për arsye të zgjedhjeve që kanë qenë zgjedhjet Komunale dhe qendrore. Është e vërtet që lista përsëritet mirëpo ato të cilat janë dhënë në shfrytëzim ato nuk i keni më, nëse jipër në shfrytëzim prona tjera në vitin tjetër ato nuk do jenë në listë më. Duhet të përsëriten sepse nuk ka prona të tjera, ato të cilat janë të publikuara munden me u shtu dhe me u largu ndonjë që jipet në shfrytëzim, mirëpo është obligim ligjor që paraprakisht janë tre kritere që do të bëhen para se të jipet një pronë në shfrytëzim është vendimi paraprap, vendimi përfundimtar dhe kontrata e Kryetarit. Secila kontrat monitorohet nga Ministria e pushtetit lokal eventualisht ndonjë ministri tjetër që ka lidhje me këto punë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Atëher jemi në proces të votimit kush është për që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës?

Për: 17

Kundër: 8

Abstenim: 0

Me 17 vota Për, 8- Kundër, 0-Abstenime kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te pika e 4 e rendit të ditës e cila është:

4. Shqyrtimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar- dhjetor 2025.

Urdhëro, Drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaqi!

Drejtor për Buxhet dhe Financa, Blerim Thaqi: Përshëndetje për të gjithë!

po e paraqes raportin e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2025, në këtë rast ju e dini që buxheti i aprovuar nga asamblea Komunale për vitin 2025 ka qenë

21,576,545.00E, por duke pasur parasysh të gjitha shtesat që kanë qenë nga të hyrat vetanake sipas tejkalimit të të hyrave për vitin 2025 ka arritur në vlerën prej 23,072,877.87E.

Për vitin 2025 mjetet e alokuara në këtë buxhet ka qenë kjo shumë që e ceka 23,072,877.87E. Realizimi i shpenzimit të mjeteve të alokuara e arrin vlerën 22,862,384.51E si përqindje është 99.09%.

Sipas buxhetit për vitin fiskal 2025, nga të hyrat vetanake kanë qenë e planifikuar të mblidhen 1,505,526.00E. fatëbardhësisht është viti i 4 që ne si Komunë i tejkalojmë të hyrat vetanake, që do të thotë vlera e të hyrave vetanake është 2,243,547.06E. Në këto pasyqra nuk janë të përfshira edhe periudha TM3-TM4 nga gjobat në trafik dhe gjobat e gjykatës që do të thotë si total i të hyrave vetanake tejaklim i tyre ka qenë vlera 1,041,000.00E. kjo ishte një pasqyre e shkurtër e raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Hapi debatin për anëtarët e asamblesë Komunale, fillimisht nga gupet parlamentare.

A ka dikush nga Nisma Socialdemokrate?

Urdhëro, Hafir Rexha!

Hafir Rexha (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit Drejtor për këtë raport, ky është një raport të cilin e paraqiti Drejtori ne grupi parlamentar i Nismës i japim mbështetje dhe e falenderojmë për raportin e të hyrave që ka bërë për këtë periudhë kohore.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtarë nga PDK): Ne e kemi analizuar raportin në disa pika kemi pasur të hyra shumë të vogla përshembull te gjobat nga inspektoriati një vlerë vetëm 2,333.00E, Hafiri është këtu pasi që ka qenë Drejtor ndoshta mundet me na tregu më shumë rreth gjobave si ka shkuar puna në teren?

Kemi pasur vërejtje në vazhdimësi për kompanit të cilat e kanë ndotur mbientin dhe hapsirat e Komunës së Malishevës po shihet që nuk kanë marrë gjobat.

Licenca të tjera për afarizëm në vitin 2024 ka pasur vlerë 67,089.00E ndërsa në vitin 2025 ka zero (0) inkasim.

Pranimi teknik i lokalit vetëm 44.00E

Taksa për leje ndërtimi është rritë si vlerë po shihet një fluks i madhë i ndërtimit.

Qka më ka bërë përshtypje te gjrobat nga trafiku që është një barrë jashtëzakonisht e madhe për qytetarët e Komunës së Malishevës, ndoshta është mirë me pas një lloj mirëkuptimi apo me bërë më shumë Komunikime me qytetarët për vetëdijësimin e tyre që me u zbrit pak këto taksa. Me ju ofru një mundësi për vetëdijësim të qytetarëve. Dhe planifikimi jo i mirë i rrugëve ka ndiku që këto gjoba të ngriten.

Drejtor pasi je këtu po të bjen ty barra unë e kam cekë dhe heren e kaluar duhet me qenë gjithëqysh një zgjidhje të lëvizjes së kamionëve sepse në vazhdimësi janë duke u gjobitur shoferët e kamionëve për arsye të mungesës së rrugëve alternative me kalu në pjesën prej Bajës nga autostrada me kalu te fshati Mirusha apo në fshatra tjera që kanë me përfundu transportin. Është mirë me na dhënë një përgjigje se si do ta shqyrtojnë këtë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, grupi i LDK-së!

Fitim Shala (anëtarë nga LDK): Ne grupi parlamentar i LDK-së kemi shqyrtuar raportin e të hyrave dhe shpenzimeve dhe japim mbështetje të plotë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, nga grupi i LVV-së!

Veton Zogaj (anëtarë nga LVV): Për besë për mua është jo serioze që diskutohet raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2025 dhe nuk është prezent as Kryetari dhe as Nënkryetari. Mendoj që është njëri prej dokumenteve më të rëndësishme që diskutohet përveqë buxhetit dhe aktert kryesor që duhet me dhënë sqarime për këto pika nuk janë prezent. Ndoshta ka mundur me qenë Kryetari i nxënë me ndonjë agjendë por për qfarë arsye paguhet në këtë rast Nënkryetari me zëvendësu Kryetarin, kështu që nuk arsyetohet asesi.

E falenderojë Drejtorin për buxhet dhe Financa që dhe në KPF është prezent vazhdimisht për pika të caktuara dhe aty ku nuk ka kompetenc sikur për Amrushin që dha sqarim. Ne duhet të bëjmë punën tonë dhe ndoshta i ndëgjon Kryetari dhe na sqaron kur do që vjen.

E para nëse e bëjmë një analiza me vitet paraprake nuk e di prof nëse je këtu, nuk e di në qfarë relacioni jemi në vitin 2024-2025 sepse në disa kategori vërehet që kemi pasur më pak inkasim të të hyrave vetanake siç janë:

Qërtifikata të tjera nuk po e kuptoj për qfarë qertifikata bëhet fjalë në raport në 2025 i kemi 43,783.20E ndërsa në 2024 kanë qenë 59,594.88E.

Taksa të tjera administrative në vitin 2025 kemi 30,565.62E ndërsa në vitin 2024 80,120.53E kemi një rënie rreth 50,000E më pak.

Gjrobat te inspektoriati që e cekti dhe Burimi kemi pak një ngritje.

Shfrytëzim i pronës publike dhe këtu kemi 50,000E më pakë në vitin 2025 është 28,440.14E ndërsa në vitin 2024 87,686.00E.

Largimi dhe deponimi i automjeteve për qfarë automjete bëhet fjalë 150.00E ndërsa në vitin 2024 është 3,000.00E.

Participimi i qytetarëve në bujqësi është vetëm 26.00E ndërsa ka qenë rreth 6,000.00E në vitin 2024.

Kemi taksa për certifikim të pronësisë dhe kopje plani në vitin 2025 kemi 4,521.50E ndërsa në vitin 2024 kemi pasur 495,925.64E është një rënie shumë e madhe dhe është mirë me na sqaru apo është gabim teknik që ka mundur me ndodhë.

Taksa për legalizim nuk kemi fare inkasim përse nuk ka në këtë kategori?

Gjobat nga gjykata në vitin 2025 kemi 29,156.73E, ndërsa në vitin 2024 ka qenë 46,098.30E.

Të hyrat nga agjencioni i pyjeve nuk kemi fare inkasim nuk e di përse nuk figuron a inkasohen këto të hyra prej agjencionit të pyjeve apo qfarë ndodhë?

Po kaloj te tabela e shpenzimeve.

Shpenzime për internet kanë qenë vetëm 6000.00E në vitin 2024 ndërsa tani janë 19,102.00E pse është kjo rritje?

Shpenzime postare në vitin 2024 kanë qenë 5,967.00E ndërsa në vitin 2025 janë 13,770.69E.

Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse në vitin 2024 kanë qenë 4,574.00E ndërsa në vitin 2025 12,930.00E përse e arrin këtë shumë kaq të lartë?

Shërbimet e ndryshme shëndetësore prej 101,670.00E është ngritur në 484,391.00E.

Shërbime kontraktuese tjera nga 373,205.00 është ngrit në 538,146.94E a është e njejta me shërbime intelektuale dhe këshill dhënëse?

Shërbime për antarsim a është asociacionin e Komunav që e paguan në antarsim dhe përse është rrit ka qenë 64,000.00E dhe është ngritur në 77,000.00E.

Shërbimet e varrimit në 2024 i kemi 0 ndërsa në 2025 2,799.00E, a është bërë pagesa me vonesë apo qfarë ka ndodhur këtu?

Paisje të tjera nuk po e kuptoj si term qfarë paisje tjera, ka qenë 14,637.00E ndërsa në vitin 2025 janë ngritë në shumën 60,055.10E.

Blerja e librave në vitin 2024 kanë qenë 54,000E ndërsa në vitin 2025 janë 104,534.70E.

Paisje sportive në vitin 20024 kanë qenë 00 ndërsa në vitin 2025 janë 19,267.60E.

Furnizim me dokumente blanko në vitin 2024 kanë qenë 16,963.00E ndërsa tani janë 17,532.30E.

Mirëmbajtja e automjeteve nga 44,000.00E në 53,208.76E

Mirëmbajtja e ndërtesave afariste 0 ka qenë në vitin 2024 ndërsa tani është 79,632.31E.

Mirëmbajtja e objekteve kulturore 0 në vitin 2024, në vitin 2025 16,869.60E.

Mirëmbajtja rrugore në vitin 2024 ka qenë 0 nërsa tani është 18,342.00E.

Mirëmbajtja rutinore nuk po e kuptoj se qfarë është, është 42,000.00E në vitin 2024 ndërsa tani është 49,000.00E.

Kompenzim përfaqësimi në vend 30,000.00E kanë qenë 2024, ndërsa në vitin 2025 36,796.80E.

Vendimet e gjykatave 201,988.00E ndërsa tani janë 261,727.95E.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Të rekomandoj në pikat e radhës ta respektosh minutazhen Veton. a ka dikush tjetër për diskutim? Nëse nuk ka kalojmë te pika e radhës e cila është:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/459, datë: 04.03.2026, për themelimin dhe emërimin e anëtarëve të KKSB-së për Komunën e Malishevës.

Lus Halitin që ta merr fjalën për prezantim të kësaj pike zyrtar nga Drejtoria për mbrojtje shpëtim dhe emergjenc.

Halit Mazreku-zyrtar nga Drejtoria e mbrojtjes shpëtim dhe emergjenc: Të nderuar anëtarë të Kuvendit, të nderuar Drejtor.

Kishillat Komunale për siguri në Bashkësi janë mekanizma komunale për siguri, themelohen për të përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin në bashkësi. KKSB siguron që të kenë anëtarë të ndryshëm, baraspeshë gjinore, nga shtesa të ndryshme nga të gjitha bashkësitë etnike dhe fetare në komunë, të cilët kanë rol në mirëqenien afëtdëshkurtër dhe afatgjatë të një bashkësie.

KKSB kanë një qasje gjithëpërfshirëse për të përcaktuar se çka përfshihet me sigurinë në bashkësi dhe se kush është përgjegjës për krijimin e një mjedisi të sigurtë. Siguria dhe rendi në bashkësi janë përgjegjësi jo vetëm e Policisë së Kosovës, por edhe zyrtarëve qeveritarë dhe shoqërisë civile. KKSB janë një forum i veçantë për t'i bërë bashkë këta hisedarë.

Themelimi, përbërja dhe funksioni i KKSB-së bazohet në Nenin 7 të ligjit nr.04/L-076, për Policinë e Kosovës dhe Nenin 3, dhe 4, të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MAPL, dhe se funksionon gjithnjë duke u bazuar në dispozitat e këtij UA.

KKSB ka për qëllim rritjen e vetëdijësimit të qytetarëve lidhur me dukuritë negative, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, identifikimin e brengave lidhur me sigurinë publike dhe rekomandimin e planeve të veprimit për t'i adresuar këto brenga në bashkëpunim me autoritetet komunale, komunitetet lokale dhe Policinë e Kosovës.

Ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve përmes ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjedhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi.

detyrat dhe përgjegjësitë e këshillit janë bazuar në Nenin 6 të UA të lartëcekur. Si organ komunal këshillues për qështjet e sigurisë, e cila në bashkëpunim me policinë e Kosovës, është përgjegjës dhe ka për detyrë që të analizojë dhe shqyrtojë të gjitha qështjet e sigurisë së komuniteteve për të mirën e gjithë qytetarëve që jetojnë në Komunën e Malishevës, me qëllim të ngritjes së vetëdijës për lloje të ndryshme të dukurive negative, prishjes së rendit dhe sjelljeve të dhunshme brenda komuniteteve lokale, si dhe identifikimin e shqetësimeve lokale sa i përket sigurisë publike.

“Siguria është jetë”

“Siguria është detyrimi i parë i një shteti”

Andaj ju ftoj që ta miratoni kërkesën dhe themeloni këtë këshillë Komunal.

Ju falenderoj!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Falenderoj Halitin për shpjegimin e këtij këshilli. Nuk ka diskutim që këshilli për siguri në bashkësi është me rëndësi dhe i domosdoshëm me u themelimi prej kuvendit tonë pasi që është obligim ligjor. Po flasim për qështje të sigurisë ku do marrin pjesë akterët kryesor të Komunës së Malishevës, prej institucioneve tona komunale e deri te institucionet e policisë, institucionet fetare e kështu me radhë. Për ne është shumë e rëndësishme që ky këshill të themelohet në kisha të kërkuar që anëtarët e këtij këshilli me qenë funksional dhe me mbajtje mbledhje sepse jo gjithëqka qdo herë duhet me u lidh me qështjen e pagesës. Shpesh herë e kemi diskutuar qështjen e pagesës dhe nëse është e mundshme ligjërishtë jamë i bindur që ekzekutivi i Komunës do ta paguaj këtë këshill, si qdo komision tjetër. Mirëpo edhe nëse nuk paguan nuk mundemi me lënë qështjen e sigurisë tonë për një meditje, është mirë me ja bërë me dije të gjithë akterëve të cilët do të jenë pjesë e këtij këshilli që ky këshill ne si

anëtarë të Nismës kërkojmë me qenë funksional sepse nuk bëhet asgjë nëse njëher në muaj ja kushton një orë për sigurin e komunitetit tonë edhe nëse nuk paguhen.
Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtarë nga PDK): Faleminderit Halit për raportin.

Padyshim që ky komision është i rëndësishëm për themelimin e këti sepse e dimë që siguria në bashkësi lokale është e domosdoshme të monitorohet nga akterët kryesor siç janë policia, po ashtu pjestarët nga kuvendi, Kryetari i Komunës së Malishevës urojë që ky komision të jetë funksional, ta përfundojë punën e tij me ndershmëri dhe në përpikmëri. Mirë e potencojë Halili që gjithësecili nganjëher duhet të bëjmë punën vullnetare për mirëqenien dhe për të mirën e qytetarëve, edhe pse munda nuk na paguhet në vlerë monetare por e rëndësishme është që siguria e qytetarëve tonë të jetë në nivel të duhur unë kisha dashur me potencu që ne si Komunë jemi një vend i qetë, kisha pasur një propozim që më shumë monitorimi me qenë edhe në aspektin e infrastrukturës në kuptimin e lëvizjeve dhe rregullimit të shpejtësis, sepse në vazhdimësi po ka aksidente. Dhe kjo është pjesë e sigurisë po ka raste me fatalitet dhe lëndime të rënda, shpresoj që dhe në këtë pjesë me qenë fokusi i këti këshilli. ne e mbështesim si parti demokratike ju dëshirojmë punë të mbarë të gjithë anëtarëve të këti komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtarë nga LVV): Faleminderit Halit për prezantimin, pajtohem me Halilin që janë disa komisione dhe komitetet që për kundër që nuk kompenzohen për punën e tyre ne e kemi me obligim me i themelu siq është KPF-ja kështu që ne e mbështesim këtë pikë të Kryetarit dhe dua të di përbërjen se sa anëtarë nga Kuvendi kanë me qenë pjesë e këti komisioni.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Halit Mazreku!

Halit Mazreku- zyrtar nga Drejtoria për mbrojtje shpëtim dhe emergjenc: E gjithë puna e këti këshilli është e udhëzume sipas ligjit si mandati si përbërja si dhe pagesa. Te neni 18 për punën e tyre anëtarët e KKSB-së paguhen nga buxheti i Komunës përkatëse, kompenzimi për anëtarët e KKSB-së për pjesëmajen në takime bëhet në shumën si anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa. Ndërsa sa i përket përbërjes, përbërja është e rregulluar me nenin 4 të ligjit administrativ përbëhet nga Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Komunës, Komandanti i Stacionit të Policisë, nga një përfaqësues i secilës bashkësi fetare, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Zyrtar për barazi gjinore, Drejtori i drejtorisë për Arsim, Kryetari i KPAK, Përfaqësuesi i FSK-Prishtinë, Përfaqësuesi i KLSB, Kryesuesi i EVSB, Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe shpëtim, Përfaqësuesi i zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Përfaqësuesi i OJQ, Mediat lokale, Kordinatori i KKSB-së.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Faleminderit Halit për sqarimin që e bëre, e votojmë themelimin e komisionit në të njëjtën kohë anëtarët që janë dhe anëtarët që do të plotësohen nga organet relevante kush është për?

Me 24 vota për (unanimisht) themelohet KKSB-ja.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është:

6. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve “Stacioni i Autobusëve” SH.A. Malishevë.

A ka debat?

Nëse nuk ka shkojmë me propozime, Urdhëro, Halil!

Ky Komision ka tre anëtarë dy nga Kuvendi dhe një nga Zyra e Kryetarit

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesues!
Atëherë unë për këtë komision propozojë Bashkim Berishën.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Hafir Rexha!

Hafir Rexha (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Nga grupi jonë propozojë Remzi Hoti!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtarë nga PDK): Kishte qenë mirë me hap debat për këtë pikë shpejtë shkove te propozimet.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Unë ju pyeta se a ka dikush për të diskutuar dhe meqë nuk pashë asnjë që nuk kërkuat fjalën, ju pyeta për propozime. Por që dëshiron me marrë fjalën për diskutim urdhëro.

Burim Paqarizi (anëtarë nga PDK): Te qështja e stacionit të autobusëve është një qështje e ndishme, mënyra e menagjimit të tyre nga raportet e tyre të cilat kanë ardhë në mandatin e kaluar dhe tani që e shikova një kërkesë gjendja e tyre financiare është e rënduar, dhe mënyra e funksionimit të tyre lenë për të dëshiruar dhe në mënyrën e menagjimit dhe në mënyrën e kontrollimit të linjave prandaj unë kisha kërkuar së pari një sqarim prej tyre, me pa se si me funksionu. E dimë që është ndërmarrje e Kuvendit të Komunës së Malishevës, me kriju një raport të mirë me shiku gjendjen e tyre a punojnë me llogari bankare apo ende e kanë të bllokuar. Sa kamë informata llogarit e tyre janë të bllokuara dhe mënyrat e pagesave bëhet me para kesh dhe mirë është me na dhënë sqarim. Ne nuk kemi propozim!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Nëse nuk ka proozime të tjera, vazhdojmë me proces të votimit!

Muharrem Morina (zyrtar ligjor): Meqenëse z.Begaj është përfaqësues i stacionit kishte qenë mirë me u deklaruar dhe me dalë jashtë sepse mund të krijosh konflikt interesi.

Gazmend Begaj liron sallën e kuvendit.

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Meqë Burimi e ngriti një tem dhe pasi që kam qenë anëtarë i komisionit të stacionit të autobusëve ne e kemi një pikë të rendit të ditës që është kërkesë e stacionit të autobusëve, mendoj që këto probleme të cilat i ngriti Burimi mund të i trajtojë në kuadër të asaj pike.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Jemi në proces të votimit Kush është për formim të këti Komisioni me emrat e propozuar?

Për: 15

Kundër: 5

Abstenim: 1

Me 15 vota për, 5-kundër, 1- abstenim formohet ky komision dhe në të njëjtën kohë i bashkangjiten propozimet e Kryetarit.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është:

7. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve “EKO- Regjioni” SH.A. Prizren, njësia në Malishevë.

A ka debat për këtë pikë? Nëse nuk ka, urdhëroni me propozime. I ka tre anëtarë dy nga Kuvendi dhe një nga Kryetari.

Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtarë nga PDK): Ne si grup i PDK-së propozojmë Albrim Morina.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Ne si grup i Nismës propozojmë Skender Zogaj!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Xhenetë Morina!

Xhenetë Morina (anëtare nga LDK): Ne si grup i LDK-së propozjmë Fitim Shala!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Faleminderit, i kemi tri propozime por i kemi vetëm dy mundësi. Vazhdojmë i votojmë një nga një propozimet.

Kush është për propozim të Burimit që Albrim Morina me qenë anëtarë i këti Komisioni.

Për: 9

Kundër: 15

Abstenim: 1

Nuk kalon propozimi i Burimit.

Vazhdojmë me propozimin e Halilit që Skender Zogaj me qenë anëtarë i Komisionit të EKO-Regjionit kush është për?

Për: 15

Kundër: 6

Abstenim: 5

Kalon ky propozim.

Propozimi i Xhenetës që Fitim Shala me qenë anëtarë i këti Komisionit, kush është për?

Për: 15

Kundër: 6

Abstenim: 5

Kalon ky propozim.

Kërkojmë nga zyra e kryetarit të na i bashkangjisë propozimet e tyre.

E votojmë në tërësi Komisionin me dy propozime të kuvendit dhe një përfaqësues nga Zyra e Kryetarit. Kush është Për?

Për: 15

Kundër: 9

Abstenim: 2

Formohet ky komision.

U diskutua qështja e pagesave besoj që në të dy komisionet kamë biseduar me Drejtorin e Financave është problem me i përfundu pagesat e këtyre komisioneve por ne do ta bëjmë një kërkes nga drejtoria e financave që të gjejë hapsir ligjore dhe interpretime nga Komuna të tjera. Kisha kërkuar që në këto vendime të shënohet që mjetet financiare për pagesë të jenë nga mallra dhe shërbime pasi po kemi probleme nga paga dhe mëditje.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është:

8. Formimi i Komiteteve jo obligative.

Kisha kërkuar nga shefat e gupeve parlamentare një takim dy minuta në zyren time për ta trajtuar këtë pikë sepse po kemi të njëjtin problem me pagesa.

Ju lus, asambleistët të rikthehen në sallë.

Kërkoj nga sekretaria që të na tregojë se a kemi kushte për vazhdim të seancës.
Kemi kourum për vazhdim të seancës. pas takimit të cilin e kishim me shefat e grupeve parlamentare u dakorduam që të largohet kjo pikë e rendit të ditës për arsye se ende nuk kemi gjetur formën për ta kryer pagesën ndaj anëtarëve të komiteteve. Kështu që përfundimi ishte që mos të krijojmë trupa të kuvendit pa pagesë, me gjetë modalitetin së bashku dhe me ministrinë që po pritet të nxirret një udhëzim administrativ për pagesën e trupave jo obligativ të Kuvendit.

Kush është për që të largohet nga rendi i ditës pika e 8. Formimi i Komiteteve jo obligative?
Unanimisht për largohet nga rendi i ditës kjo pikë.

Pika e radhës është: 9. Formimi i Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale.

Ashtu siç jeni në dijëni këshillat lokal përfundojnë mandatin me përfundimin e asamblesë Komunale, kanë qenë një mandat tri vjeçarë kështu që madnati i tyre ka përfundura dhe ne do të formojmë një komision për mbarëvajtjen dhe zgjedhjen e këshillave në bashkësi. përbërja e ati komisioni është: Secili grup parlamentarë nga një përfaqësues, Kryesuesi i Kuvendit, dy anëtarë nga zyra e Kryetarit dhe një nga OJQ. Nëse keni ndokush propozime udhëroni?
Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Ne si grup i Nismës propozojmë Hafir Rexhën!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtarë nga PDK): Ne si grup i PDK-së propozojmë Demir Bajra!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Xhenetë Morina!

Fitim Shala (anëtarë nga LDK): Nga LDK propozojmë Arlind Morina!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro LVV!

Veton Zogaj (anëtarë nga LVV): Ne propozojmë Vlera Bytyçi.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, AAK!

Enver Bytyqi (anëtarë nga AAK): Ne propozojmë Luan Morina!

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Faleminderit.

Presim edhe dy propozime nga zyra e Kryetarit dhe një propozim nga OJQ që të kompletojmë Komisionin.

Atëherë kush është për që të formohet ky komision me këtë përmbajtje që e diskutuam? Të qështja e pagesës i njëjti vazhdon komunikimin me drejtorin e financave për të kryer pagesën nga mallra dhe shërbime në vlerë prej 50euro për takim.

Kush është për?

Unanimisht për.

Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës. I kemi dy kërkesa në vazhdimësi.

Pika e 10. Shqyrtimi dhe miratim i kërkesës nr.02/46, datë 10.03.2025, për lejimin e kompensimit të tokës të marra në ngadastrat 991 dhe 992 për nevojat e zgjerimit të rrugës “Hamdi Berisha” në Malishevë.

A ka dikush për të debatuar për këtë pikë.

Halil Morina-Kryetar i Kuvendit: Faleminderit Kryesues!

Unë paraprakisht dua ta ndëgjoj nga Drejtori i gjeodezisë se si është çështja e kësaj lënde, sepse zakonisht kërkesat kur të vijnë i drejtohen kryetarit të komunës, pastaj Kryetari i komunës në pajtim me drejtorin e gjeodezisë nëse është e kompletuar kërkesa pala ka të drejtë. Kur na vjenë kërkesa prej kryetarit të komunës, ne e edim që kryetari i komunës e ka shqyrtu atë lëndë pra është pa që pala ka të drejtë dhe duhet me ju kompenzu prona.

Dua nga drejtori i gjeodezisë dhe i pronës a është në rregull dhe a kam të drejtë që unë si anëtar i kuvendit me marr vendimin. Dua një interpretim të di se si është qështja rreth kësaj kërkesë.

Fatmir Ademaj-Kryesues i Kuvendit: Faleminderit Halil!

Po i referohemi të dy kërkesave pika 10 dhe 11 kanë kalu në KPF dhe është kërkuar nga zyra e gjeodezisë, interpretimi nga drejtori kemi marrë se gjithçka është në rregull por nuk bëjë rend të ditës pa u konsultuar me kryetarin e komunës. Besoj që kryetari i komunës është dakorduar dhe e ka marrë rekomandimin nga drejtoria përkatëse pra nga e pronës dhe gjeodezisë.

Po e hapi debatin rreth kësaj pike.

Fjalën e ka Veton Zogaj.

Veton Zogaj (anëtar nga LVV): Faleminderit Kryesues pajtohem plotësisht me Halilin, unë kam thënë që po i aprovojmë me i dërguar në Kuvend me plotësim që me na ardhë shkresa prej Drejtorive përkatëse, e plotësuar si kërkesë dhe me informacione shtesë, unë nuk po e shohë atë informacion që ka ardhë ka mundur në mënyr interne me ju dhënë, por meqë nuk e kemi unë kisha kërkuar që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhëshme.

Fatmir Ademaj-Kryesues i Kuvendit; Faleminderit Veton!
Urdhëro, Bashkim Krasniqi.

Bashkim Krasniqi (anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Faleminderit kryesues!

Si kerkese pra është qe një kohë të gjatë dhe lidhet me një qështje që është bërë zgjerimi i rrugës mbrapa gjimnazit e deri te rruga e lagjes Mirëdita mirëpo nuk është bërë kompenzimi ashtu siq është marr sipërfaqja e pronës private. Kur ka ardh si kërkesë në vitin 2017 e njëjta situatë qysh e ka paraqit pala, ashtu është konstatuar nga gjeodetët e Komunës së Malishevës, kur a bërë ekzekutimi në teren është marr më shumë sipërfaqe se sa ajo që është për projekt, kështu që pjesa që nuk është kompenzuar kërkohet nga pala që të kompenzohet.

Edhe unë mendoj që gjithë ata të cilët kanë pika duhet të jenë prezent dhe sqarimet me i dhënë këtu. Në vitin 2017 ka pasur sqarim nga Drejtoria e kadastrit ku Drejtor në atë kohë ka qenë Blerim Thaçi dhe i ka dhënë sqarimet është realitet që është marrë më shumë sesa që është kompenzuar, kështu që pala kërkon që të i bëhet këmbi i pronës me pronë komunale. Unë e vlerësoj që secila pronë private duhet me pasë një arsye nëse veq cenohet dhe në këtë rast është bërë rregullimi i rrugës dhe trotuarit dhe i është marrë prona, përkëtë arsye pala ka të drejtë që të kompenzohet, unë jamë për të ju kompenzuar nëse ju duhen informacione shtesë është mirë të i specifikojnë qfarë ju duhet konkretisht dhe mos me i lëviz kërkesat prej një mbledhje në mbledhjen tjetër.

Fatmir Ademaj-Kryesues i Kuvendit: Faleminderit Bashkim!
Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtarë nga PDK): Faleminderit Kryesues!

Kjo pikë besoj që është pik e rëndësishme me diskutu, por ne kemi një palë që po kërkon kompenzimin e pronës, që ju ka marrë prona për me u shfrytzu rruga. Unë kisha kërkuar që të kemi raportin nga Drejtoria përkatëse më të detajuar. Përsoni i cili e ka realizuar kërkesën e ka vendos kopjen e planit por nuk kemi kopje zyrtare nga drejtoria e Gjeodezis në raportin e komunes që të dim saktë për cilën parcel po bëhet fjalë, sa metra katror do të ju kompenzohen të jepet arsyeja mirë se qfarë po kërkohet. Në këtë rast ne votojmë kundër për arsye të mungesës së një raporti nga ana e Drejtorisë së Gjeodezisës, po nëse kjo pik shtyhet në një mbledhje të radhës dhe kemi të bashkangjitur një raport nga Drejtoritë përkatëse atëher ne e shqyrtojmë dhe vazhdojmë tutje.

Fatmir Ademaj-Kryesues i Kuvendit: Faleminderit Burim!
Urdhëro, Valjetë Hoti!

Valjetë Hoti (anëtare nga PDK): Pajtohna plotësisht me parafolësit, është kërkes plotësisht e drejt për mënyren qysh është përpilu kjo kerkese kisha thënë që është një kërkes shumë konfuze. E kemi një aktvendim që është marrë në vitin 2002 për korigjimin dhe matjen që është marr në vitin 1989, pastaj në vitin 2017 është refuzuar kërkesa për shkak se është vërtetuar se ka gabime

teknike në aktvendim. Kërkesa pastaj është bërë me 03.04.2017 ku në KPF anëtarët kanë kërkuar një raport sqarues nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster, drejtoria në fjalë ka kthyer përgjigje kanë vlerësuar që është një kërkesë e drejtë dhe janë vërtetu edhe gabimet që janë bërë, mirëpo në bazë të kësaj kërkesë janë përfunduar zhvillimet për sa i përket kësaj çështje. Kështu që nuk është shpjeguar kërkesa çka ka ndodh në vitin 2017, a është shqyrtuar a ka pasur ndonjë vendim? Më mirë kishte me qenë nëse shtyhet kjo pikë për mbledhjen tjetër.

Fatmir Ademaj-Kryesues i Kuvendit: Faleminderit Valjetë! A ka dikush diçka nga anëtarët e kuvendit?

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Ne jemi një shtet demokratik ku për neve prona është e shenjtë dhe çdo cenim i pronës private duhet me u kompensuar dhe nuk ka diskutim, mirëpo vet fakti që kjo lëndë është shty kaq shumë më shumë më shton pasigurinë dhe asesi nuk jamë që këto kërkesë të hudhën poshtë prej neve me votë sot, por unë kërkojë që këto kërkesa në mënyrën e duhur dhe konsiderojë që është më mirë edhe për neve edhe për palën, pra nëse kjo lëndë është shty kaq shumë konsiderojë se duhet të shtyhet deri në seancën e ardhëshme në mënyrë që ta definojmë qartë, të na vjen kërkesa si duhet dhe të paktën që mbrenda kësaj kërkesë ta kemi dhe një interpretim të tanishëm nga Drejtoria e Gjeodezisë në mënyrë që të votojmë lirshëm.

Fatmir Ademaj-Kryesues i Kuvendit: Faleminderit Halil!

Urdhëro, Enver Hoti!

Enver Hoti (anëtarë nga AAK): Faleminderit Kryesues!

Kjo është një kërkesë që ka ardh nga një palë që nuk duhet vëjmë në pikëpyetje të drejtën e tij për të kërkuar pronën e vet, por nuk është e furnizuar nga asnjë material shtesë nga asnjë Drejtori përkatëse të Komunës. Së pari kërkesa që e ka paraqit pala për 108 metra katrorë ka kërku 450 metra katrorë për një zonë të caktuar. Janë disa qështje që duhet me i trajtu më ndryshe. Nëse është bërë planifikimi i rrugës më herët dhe është zgjeruar, a janë shqyrtuar të gjitha qështjete në aspektin e pronësis dhe sa është vlera e kësaj prone? A duhet të i dhëjmë pronë patjetër apo mundet të zgjidhet ndonjë kompensim tjetër? Përse duhet të ja dhëjmë pronën kur ka mundësi ndryshe me ja kompenzu, nëse e ka shfrytëzuar Komuna për interes publik zgjerimin e rrugës, mundet dhe me para me ja dhënë jë vlerë. Unë mendoj që Komuna ka prona shumë të kufizuara dhe duhet me u shqyrtu kjo, mëndo j që është më mirë me u trajtu dhe me u largu si pikë. Por duhet të kemi kujdes sepse nuk ne nuk bijmë nga pa përgjegjësia jonë ligjore nëse marrim një vendim.

Fatmir Ademaj-Kryesues i Kuvendit: Faleminderit Enver!

Urdhëro, Demir Bajra!

Demir Bajra (anëtarë nga PDK): Faleminderit Kryesues!

Unë ju bashkangjitem parafolësve, Kryesues kam kërkuar së paku fizikisht të na sjellni materialin sepse përmes emailit dhe telefonit nuk po mundem në mënyrë të detajume me shiku se çfarë jemi duke bisedu. Kemi pasur bised me Kryetarin dhe zgjerimet e rrugëve kur kanë ndodhur në Malishevë urbane nuk kamë qenë kundër sepse jetoj në Malishevë, por nuk e kam paranu në atë kohë sepse i kamë thënë ku janë mekanizmat e pushtetit që ta kqyrin punën e vetë me seriozitet. Ku është Drejtori i Gjeodezisë përse njerëzit kompetent të cilët duhet me qenë sot, pas 10 vitev ne me shqyrto një pikë të rendit të ditës me ju bërë kompenzimi x përsonit kur ka mundur me përfundu me kohë. Duhet të kemi informata se a e kemi të ligjshme me votu apo të paligjshme, jo vetëm për hater që e keni tezak apo të familjes. Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës besoj që i kanë mekanizmat e vetë që duhet ta marrin punën me përgjegjësi dhe njerëzi, sepse paguan për ata. e jo unë me ra në këtë qështje, ja ku është personi ligjor i cili duhet të na jep informacione, ndërsa Drejtori i Kadastrit i cili duhet me qenë këtu nuk është, nga me u bazuar ne që ta votojmë këtë kërkesë. është mirë disa gjëra me i shiku me sllajde Kryesus kur dëshirojmë me votu diqka, jo vetëm të votojmë dhe mirëupafshim.

Fatmir Ademaj-Kryesues i Kuvendit: Faleminderit!

Urdhëro, Hafir Rexha!

Hafir Rexha (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesues!

Në bazë të kërkesës që ka bërë personi ngjarja ka ndodh prej vitit 2002 e 2017 dhe ka ardh deri këtu, është me të vërtetë pak e pa qartë për neve kështu që i bashkangjitem parafolësve që kjo kërkesë së bashku me të dytën që është pas kësaj kërkesë të largohen prej rendit të ditës ose mos të shqyrtohen deri të jetë e detajuar me këto raporte të cilat po kërkohen.

Fatmir Ademaj-Kryesues i Kuvendit: Faleminderit Hafir!

Realisht Asambleja Komunale ka filtra ligjorë kështu që çdo vendim i Asamblesë Komunale filtrohet dhe duke e parë shumicën e Asamblesë Komunale atë interpretim që e ka dhënë drejtori i Gjeodezisë në mënyrë figurative që në rregull është dhe i ka punu dokumentat në zyrën e kryesuesit përmes zyrës së Asamblesë Komunale delegojë nga zyra e Gjeodezisë të kompletohet i gjithë dokumentacioni për këtë pikë të rendit të ditës dhe të na sjellët a ka bazë ligjore kërkesa e qytetarit dhe të trajtohet në mbledhjen e pare ose në mbledhjen që do të vijnë. Kush është për që të largohet kjo pikë e rendit të ditës?

Unanimisht për.

Faleminderit!

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

11.Shqyrtim dhe miratim i kërkesës 02/109, dt. 29.04.2025 për njësimin e procedurave të këmbimit të pasurisë.

Urdhëro, Hafir Rexha!

Hafir Rexha (Anëtar nga Nisma Socialdemokrate): Unë e thash edhe më parë që kjo pikë e rendit të ditës bashkë me të parën të largohet nga rendi i ditës.

Kryesuesi i Kuvendit-Fatmir Ademaj: Mirë atëherë pa shkuar në debat, kush është që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet?

Unanimisht për.

Faleminderit!

Kalojmë te pika e radhës e rendit të ditës e cila është:

12. Shqyrtim dhe miratim i kërkesës 02/77 dt. 19.03.2026 për subvencionim të NPK Stacioni i Autobusëve SH.A. Malishevë.

Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi (anëtarë nga PDK): Para se të paraqitet kjo kërkesë ne kemi kërkuar që të na vijë një raport i mënyrës së funksionimit të stacionit të autobusëve, ne e dim se si ndërmarrje publike nuk është se nuk gjeneron të hyra, pra e ka potencialin me gjeneru të hyra dhe sa është logjika që na shumën prej 25,000.00E në një institucion i cili mund të jetë një institucion i cili kish pas me na gjeneru neve të hyrat si Komunë, jo na me subvencionu atë si institucion. Kjo është arsya pse ne po e kërkojmë një raport të detajuar prej kësaj kompanie, që të shohim se cila është mënyra e funksionimit të tyre.

Kompanit të cilat i shfrytëzojnë hapsirat e stacionit të autobusëve a janë duke i përfunduar obligimet e tyre? Ne e dimë që ato në vazhdimësi gjenerojnë dhe kryejnë shërbime për qytetarët e komunës së Malishevës të gjitha ato janë me pagesë, asnjë qytetarë i komunës së Malishevës nuk udhëton pa pagesë, prandaj dhe ato kompani duhet të i përfundojnë obligimet e tyre ndaj kompanisë së stacionit të autobusëve. Është bërë një investim i stacionit të ri a është duke funksionuar apo qfarë është duke ndodhur në ato hapsira? Ne jemi kundër kësaj kërkesë dhe nuk e mbështesim, kërkojmë një raport të detajuar nga kjo kompani.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Faleminderit!

Raportin besojë që e dergojnë në komision të aksionarëve.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Faleminderit Kryesues!

Si anëtarë i këtij Komisioni në mandatin e kaluar ka qenë duke funksionu komplet jashtë sistemit, me gjirolllogari të bllokuara për shkak të mos pagesës të institucioneve të ATK-së dhe stacioni i autobusëve ka qenë totalisht tu funksionu jashtë sistemit, por ne i kemi zgjedh organet siq është bordi drejtues i stacionit të autobusëve, bordi e ka zgjedh krye shefin, ka fillu puna. Stacioni i autobusëve i ka shly të gjitha detyrimet që i ka pas nga ATK-ja, llogaritë janë liruar, stacioni i autobusëve ka filluar të funksionojë normal, të hyrat e stacionit të autobusëve kanë qenë njejtë me shpenzime, sepse duke pasur parasysh ne duhet patjetër të kemi stacion të autobusëve. zakonisht ndërmarrjet publike krijohen me sjellë të hyra për Komunën, mirëpo janë

disa ndërmarrje publike që duhet në qfarë do llojë forma me ekzistim, sepse edhe në qoftëse nuk na sjellë të hyra ne nuk mundemi me lënë Komunën tonë pa stacion të autobusëve. duhet të gjejmë forma të ndryshme se si me subvencionu këtë kompani në mënyr që ajo me funksionu. Fakti që stacioni i autobusëve është prap borgj ndaj stafit të vet jo ndaj ATK-së dhe institucioneve shtetërore, është sepse gjatë mandatit të kaluar për arsye të punimeve të cilat janë bërë në qytet shumica e autobusëve nuk kanë mundur të hyjnë në stacion dhe kjo i ka ulë të hyrat e stacionit të autobusëve, sidomos kur flasim për linjat ndërurbane kur vijnë prej qyteteve të tjera. Një problem na ka ndjekë në vazhdimësi që nuk kemi mundur asnjëher me zgjedhë, që nuk kemi mundur me gjetë bashkëpunim me institucionet e Komunës përkatësisht me Drejtorin e shërbimeve publike dhe Drejtorin e inspektoriatit ka qenë që shumica e autobusëve urban komunal nuk hyjnë në stacioni e autobusëve me bërë pagesën dy euro që hyjnë në stacion të autobusëve. Zakonisht po thuhet 100% linjat ndërurbane kanë paguar, por këta që janë urbane të Komunës së Malishevës nuk kanë paguar. I lus këto Drejtori që me ju bërë obligim autobusëve të cilët operojnë në Komunën e Malishevës me hy në stacion të autobusëve sa herë që e ka linjën ose përndryshe mos me ju dhënë vija të njejtav kompani.

Duhet një kordinim i mirë në mes të Komisionit të aksionarëve, Drejtorisë së shërbimeve publike dhe Drejtorisë së Inspektoriatit të zgjidhet kjo qështje. Në qoftë se të gjithë ata që kanë linja mbrenda urbane hyn në stacionin e autobusëve, stacioni i autobusëve ka me pas të hyra të mjaftueshme, jo vetëm për pagimimin e stafit të vet, por edhe të bëjnë ndonjë investim mbrenda institucionit të autobusëve. Unë inkurajojë komisionin e tanishëm që me u marr seriozisht me këtë qështje.

Sa i përket kërkesës së stacionit të autobusëve unë konsiderojë se është lëgjitime sepse 2-3 vjet prej investimeve në qytet nuk ka mujt me i gjeneru të hyrat, andaj unë kërkojë prej drejtorit të financave me pa se sa janë mundësitë buxhetore, dëshira jonë është me i ndihmu por duhet me i shiku edhe mundësitë tona financiare a janë në dispozicion që me realizu na këtë kërkesë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj (anëtarë nga LVV): E para sa i përket ndërmarrjes së stacionit të autobusëve kjo i ka bërë afër 10 vite që komuna e ka si barrë në shpinë prej kohës së Ish Kryetarit Begaj. Më kujtohet që e kemi subvencionu stacionin e autobusëve së paku në dy tre raste dhe prap ka mbetë e njëjt. Po ashtu nuk duhet të harrojmë që stacionit të autobusëve Komuna ja ka ozorpar pronën, rrethi që është te stacioni i autobusëve është në pronë të stacionit. Arsyeja përse nuk kanë mundur me hyjë autobusë në stacion gjatë kohës së punimeve ka qenë fajtores vetë Komuna. Në vend që me u investu në objektin që ka mbetur prej vitesh sistemi i viteve të 90-ta e kanë lënë në gjendje të mjerueshme, tani kërkon subvencionim për paga të punëtorëve. Unë besoj që duhet me u marr seriozisht me këtë qështje, kompanit të cilat operojnë linjat urbane, ndër urbane një cent me u ngrit qmimi i naftës na ngrit tarifën e biletës udhëtarëve, nxënësve ndërsa stacioni ka mbetë me një tarifë prej 2euro që nga viti 2000. nëse ata e kanë ngrit biletën ngrite dhe ti qmimin për hyrje në stacion. po ashtu inspektoriatit ne e pamë në raport të hyra vjetore ka 2000E përse nuk e bënë punën seriozisht këta kombibusa dhe autobusa të cilët nuk hynë në stacion me i gjobit. Jemi kundër në parim pa na dhënë një raport sqarues ndërmarrja. Përse po i kërkon këto para? Përse nuk ka gjeneruar të hyra? Kush janë shkaktarët? A është marrë me Komunën që ja ka ozorpar pronën? kur ta sjellë këtë raport ne e shqyrtojmë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Hafir Rexha!

Hafir Rexha (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Sa i përket ndërmarrjes së stacionit të autobusëve, kjo ndërmarrje fillimisht ne si Kuvend Komunal jemi munduar shumë deri e kemi kthyer si pronë komunale prej Prizrenit, pagat i kanë marrë kesh nuk kanë pasur gjyrollogari. me formimin e Komisionit të aksionarëve nga Kuvendi Komunal kanë filluar hapat e parë. Stacioni i autobusëve fillon të rrikëmbet por për arsye të punimeve në transformimin e Malishevës prej një qyteti në Malishevë Urbane ka hasur në pengesë që stacioni i autobusëve mos të ketë gjenerim të hyrave. Sa i përket rregullave të tjera siq është hyrja e autobusave dhe kombibusave ne kemi rregulloren komunale që është për ngastra për ngarkim dhe gjoba komunale të vitit 2024, në këtë vitë besoj do ta kemi atë rregullore për shqyrtim dhe miratim, unë pajtojë me parafolësit që duhet të përcillet trendi i zhvillimeve dhe për këtë kompani, sepse me të vërtetë hyrja është shumë e ulët dhe nuk kanë pasur mundësi me hy. Barrë e stacionit të autobusave është bërë edhe objekti i ikubatorit që e kemi ndërtuar atë herë dhe tani për nevoja të Komunës është shëndrruar një pjesë për Drejtorin e mirëqenies sociale. Kisha kërkuar të bëhet dhe një hapje nga pjesa tjetër te stacioni i autobusëve sepse të gjithë ata të cilët po kanë shërbime në këtë institucion po duhet të hyjnë në stacion të autobusëve dhe ju shkaktojnë shumë probleme he bëhet një hyrje-dalje e pa kontrolluar, kështu që kisha propozuar që pjesa e qendres për punë sociale, drejtoria e shëndetësis ta ken një dalje tjetër dhe stacioni i autobusëve, komisioni që do të themelohet sot së bashku me menagjerin dhe organet kompetente ta bëjnë një plan operativ dhe të fillojnë të punojnë, mbas dy tre muajve të na sjellin një raport me të hyra dhe besoj që ka me pas të hyra. Ka pas rast janë grumbulluar 44,000.00E mbrenda viti, kur unë kamë qenë anëtarë i këtij komisioni nga kuvendi komunal.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Enver Hoti!

Enver Hoti (anëtarë nga AAK): Kërkesa e cila ka ardhë për subvencionim të ndërmarrjes publike komunale të stacionit të autobusëve, është e përqendruar vetëm te pagat e punëtorëve, kishte qenë mirë me na sjellë një listë sa punëtorë i ka, me ditë dhe ne a po shtohet numri a jo. Pajtojë plotësisht me parafolësit që është dashur me sjellë një raport që neve na informon mbi gjendjen dhe hapsirat e stacionit të stacionit, kush i shfrytëzon, cilat janë të hyrat? Hafiri e cekti një shifër 44,000.00E duhet të na tregojnë nga hyjnë ato. kërkesa tjetër mos kordinimi ndër institucional siç është Drejtoria e shërbimeve publike dhe inspektoriati kjo është me të vërtetë qesharake, kjo është një ndërmarrje Komunale dhe kot ankohum këtu përse nuk ka mundur me detyru një kompani të transportit që të hyjnë në stacion të autobusëve. është një kërkesë që ndoshta njerëzit kanë nevojë por është e zbrazët. e cekti dhe ndërtimi i inkubatorit që ka qenë për biznese, që e paska marrë në shfrytëzim komuna. ka qenë një investim nga qeveria qendrore e ka hapur me i zhvillu bizneset, ato biznese janë planifiku me i sjellë të ardhura në të ardhmen stacionit të autobusëve. Unë pajtojë që duhet me shfrytëzu Komuna apo institucioni qerat sepse nuk ka hapsir. A nuk ka hapsir me ardhë Drejtoria këtu diku dhe me shfrytëzu atë hapsir në ndonjë shërbim që kish ofru të hyra? Nuk e di a është krejtësisht e planifikuar siq duhet apo jo?

prandaj pajtojë me kolegë që kjo kërkesë nuk duhet të pranohet, ju i keni votat mundeni me kalu por është totalisht gabim.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Unë dhe një her dua të tregojë që kjo kërkesë është legjitime dhe e arsyeshme, kërkoj prej drejtorisë së financave që me i pa mundësit buxhetore se sa kemi mundësi ta mbështesim ne si kuvend këtë kërkesë në plotni apo mundemi me mbështet aq sa ka mundësi financiare kuvendi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Demir Bajra!

Demir Bajra (anëtarë nga PDK): Halil ne e dimë që i keni votat, por letë na vjen ndonjëher ndonjë material i detajuar se si është gjendja e stacionit të autobusëve. Ne po falsim për diçka që ti nuk je në gjendje me sjellë si akterë, si kuvend i Malishevës me i pas njerëzit e tu, ku janë Drejtorët që duhet me qenë kur bisedojmë për pika e rendit të ditës. Nuk je në gjendje me i tubu mjetet autobusat dhe kombibusat që nuk hynë aty, ai është i obliguar të hyjë qoftë 1E qoftë 3E. Të jemi më seriozë në këto punë, Nisma e ka mandatin e 4 qeverisës mendoj që duhet ta marrim model në të ardhmen kush do që ta qeverisë komunën e Malishevës, jo ne tash te një pikë e rendit të ditës nuk jemi duke ditur se qfarë po kërkojnë, me i votu 25,000.00E, dhuronju edhe njerëzve të cilët hyjnë në stacion që kanë nevoj, pasi qenka mundësia dhuronju.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: A ka për diskutim? Nëse jo urdhëro, Drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaçi.

Drejtori për Buxhet dhe Financa- Blerim Thaçi: Duke pasur parasysh që kategoria e subvencioneve për këtë vitë janë 600,000.00E dhe duke pasur parasysh që kryejmë shumë shërbime që nxjerren nga kuvendi Komunal, zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Kulturës. duke pasur parasysh që dhe viteve të tjera kemi subvencionu stacionin e autobusëve, duke pasur parasysh sfidat që i ka pasur stacioni i autobusëve. Në këtë kosto qfare është paraqitur kërkesa është e vështirë të realizohet, nëse do të ishte e mundshme ulja e shumës së kërkesës të paktën në 10 ose 15,000.00E do të ju jepte mundësia të subvencionohet stacioni i autobusëve.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Enver Hoti!

Enver Hoti (anëtarë nga PDK): Kur kemi kesi kërkesa është mirë me dalë me marrë fjalën Drejtori se a kemi mundësi me i ndihmu dhe po i paraqet arsyet e veta përse duhet ta mbështesim

këtë kërkesë. Drejtor për sa puntor është fjala që duhet me i paguar dhe a janë puntorë të rregullt apo me kontratë mbi vepër. A ka mundësi me na treguar kërkesën dhe për sa persona po kërkojnë të paguhen pagat? Sepse është keqë dhe për ne nëse votojmë kundër dhe dikush punon për një pagë mujore dhe në fund nuk merr pagë, kush janë ata puntorë jo me emra por me numra.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Meqë Drejtori na tregojë mundësit financiare, ne nuk jemi të interesuar me votu kërkesën në plotëni nëse nuk ka mundësi financiare sepse është e kotë. pasi që Drejtorja e financave ka mundësi në vlerë 15,000.00E besoj që kjo vlerë disa prej nevojave të stacionit të autobusëve i kryenë, këto nevoja janë të cekura dhe në kërkesë. Ne jemi të obliguar me ligjë që në ndërmarrjet publike lokale të krijojmë borde të drejtorëve të atyre ndërmarrjeve dhe stacioni i autobusëve e ka një bord të drejtorëve, dhe ne kemi marrë një vendim sesi paguhet bordi i Drejtorëve dhe për arsye se stacioni i autobusëve ka qenë i penalizuar për arsye të punëve të cilat ne i kemi bërë për qytetin e Malishevës neve na takon që ta mbështesim këtë ndërmarrje. ne duhet me pasë një stacion të autobusëve, ne jemi Komunë e vogël të hyrat janë shumë të vogla nganjëher kemi problem me linja sepse në mandatin e kaluar ka pasur linja që nuk kanë pasur llogari me bërë rrugën me ardhë psh. prej Berishës deri në Malishevë, sepse ka pasur shumë pak udhëtar, me ndërpre lidhjen i penalizojke disa udhëtar, për këtë arsye nganjëher janë toleruar që mos të hyjnë në stacion në mënyr që me mbajtë një linjë mos me lëshu. kështu që ne si grup i Nismës mbështesim këtë kërkes me propozim të Drejtorit të financave në vlerën 15,000.00E.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

Drejtori për Buxhet dhe Financa- Blerim Thaçi: Enver unë nuk jamë i paisur me kërkesë, për arsye se kërkesa i është drejtuar kuvendit nuk e di sa punëtorë dhe nuk i di arsyet. është kërkes e drejtuar juve unë vetëm e dhashë përgjigjen e mundësive të realizimit të kërkesës.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Nga ajo që e ceku Halili që kërkesa të aprovohet pjesërishtë pra maksimumi me qenë 15,000.00E me subvencionu stacionin e autobusëve. Kush është për që kërkesa e stacionit të autobusëve të subvencionohet pjesërishtë me shumën 15,000.00E?

Për: 14

Kundër: 10

Abstenim: 1

Me 14 vota për, 10-Kundër, 1- Abstenim kalon kjo kërkesë.

Siç u dakorduar te rendi i ditës kemi dy kërkesa, kisha kërkuar nga përfaqësuesi ligjor që të na jep një sqarim rreth kërkesës së par e cila është:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/540 datë: 18.03.2026, të ndarjes së sipërfaqes prej

4/ha, nga sipërfaqja e tërësishme prej 166118m² për përkufizimin e lokacionit të deponisë për Mbeturina Inerte, të përcaktuar sipas vendimit të Kuvendit nr.02/219, datë: 05.05.2022, si dhe 4 ha për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve afariste, nga njësia kadastrale P-72316001-02053-0, në vendin e quajtur Gajrak-Rruga, me kulturë tokë pyjore mali klasit 6, në pronësi të KK-Malishevës.

Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina- Zyrtar ligjor: Të dy kërkesat janë kërkesa të cilat janë shqyrtuar në mandatin e kaluar, të dy vendimet janë marrë pozitive në kuvend, mirëpo gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë me MAPL-në kërkesa në fjalë është kërkuar që ta rishqyrtojë komuna vendimin për arsye se Ministria ka kërkuar që së pari ta ndajmë parcelën në dy njësi kadastrale siç e keni në kërkesë pastaj të jepen në shfrytëzim. besoj që sekretaria ju ka dhënë dhe shkresat e Ministrisë së pushtetit lokal, vendimi i ministrisë është i cekur në arsyetim thotë që duhet të ndahet parcela prej 16h në dy njësi kadastrale sepse në të njëjtën njësi kadastrale Komuna në vitin 2023-24 e ka caktuar lokacionin për hudhjen e mbeturinave inerte. Ne në vitin e kaluar kemi dashur ta dhëjmë në shfrytëzim deponinë që një kompani ose një person fizik ta merr në shfrytëzim duke i paguar qera Komunës për sipërfaqen të cilën e merr, dhe një kohësishtë të bëjë organizimin e deponisë që të gjitha materialet inerte në Komunën e Malishevës të hudhen në atë deponi. Vendimi ka qenë në këtë destinim dhe një pjesë tjetër është menduar të jipet në shfrytëzim për qëllime afariste. Është e njëjta ngastër, dhe ministria ka thënë nga një ngastër me i nda në dy ngastra, pastaj të jipen në shfrytëzim deri në 15 vite jo afatë gjatë. Mundet me thënë dikush përse nuk e keni përfunduar në vitin e kaluar, arsyeja ka qenë që vendimet kur janë kthyer në rishqyrtim asamblea më nuk ka pasur kompetenc ligjore me i shqyrtu këto vendime për arsye të zgjedhjeve.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Në mandatin e kaluar kur kemi marrë vendim për ndarje të kësaj parcele për me u kriju një deponi e mbeturinave inerte, jemi të vetëdijshëm që Komuna e Malishevës ka nevojë shumë të madhe për një deponi të tillë, secili prej juve ka të kalojnë ka rrugët e fshatrave i shihni mbeturinat inerte që janë të hudhura sepse nuk kanë vend ku me i hudhë. Kështu që meqë është obligim ligjor që parcela të ndahet në dy pjesë ne si grup konsiderojmë që ne duhet ta ndajmë këtë parcelë në mënyrë që të krijohet një mundësi për shfrytëzimin e kësaj parcele për deponi.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Bashkim Krasniqi!

Bashkim Krasniqi (anëtarë nga Nismasocialdemokrate): Unë deshta me diskutu dhe me na dhënë edhe njëher sqarime sepse është vendim nga asamblea e kaluar. Me sa kuptojë duhet të ndahet njëher parcela dhe pastaj të fillohet me procedura të tjera për dhënie në shfrytëzim dhe

pjesa e cila do të ndahet a do të bëhen dy vendime të ndara, dhe pjesa që do të ndahet a do të caktohet tani destinimi apo do të vjenë pastaj si vendim për qfarë do të jipet në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina-Zyrtar ligjor: Tani për tani jemi në fazën e procedurës administrative ku kemi vetëm ndarjen e parcelës. ku kjo parcelë do të ndahet në dy njësi kadastrale të reja nga parcela am, që realisht bëhen tri. Parcela e parë është caktuar lokacioni për materiale inerte na duhet vetëm përkufizimi i kësaj ngastre ku janë caktuar 16h, por realisht nuk dihet se ku është ajo, dmth është përkufizimi i deponisë inerte. I njëjti vendim do të vjenë prap këtu që me u shpallë ankandi publik që komuna nuk ka kapacitete dhe staf me menagju një pikë që merret me grumbullimin e mbeturinave inerte, dhe në këtë rast Kryetari ka menduar me dhënë në shfrytëzim. E para me kriju të hyra dhe e dyta materialet inerte inerte me shku komplet në atë lokacion të caktuar. Pjesa tjetër që ka me u marrë vendim i ri ka me u mendu që ka me u dhënë në shfrytëzim deri në 15 vite për qëllime afariste, pra janë dy vendime që kan me u nda. Kjo është procedura.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Kalojmë në procedurën e votimit të kërkesës nr.01/540 datë: 18.03.2026, të ndarjes së sipërfaqes prej 4/ha, nga sipërfaqja e tërësishme prej 166118m² për përkufizimin e lokacionit të deponisë për Mbeturina Inerte, të përcaktuar sipas vendimit të Kuvendit nr.02/219, datë: 05.05.2022, si dhe 4 ha për qëllime të zhvillimit të aktiviteteve afariste, nga njësia kadastrale P-72316001-02053-0, në vendin e quajtur Gajrak-Rruga, me kulturë tokë pyjore mali klasit 6, në pronësi të KK-Malishevës. Kush është për?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 8

Me 16 vota për, 0-Kundër, 8-Abstenime kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është:

Propozim për shqyrtim të mëtejme të kërkesës nr. 01/35, dt.21.03.2025, të parashtruar nga DHF-Company “sh.p.k, ne numër uni identifikues (NUI) 810746670, me seli në Pejë, rruga UQK-së, sipas Autorizimit që e përfaqëson Avokat Qendrim Arifaj, nga Arifaj dhe Partner’s, Laë Firm L.L.C, me numër unik identifikues 812060862, me seli në Prishtinë, rr.Tring Smajli” nr.10/6.

Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina-Zyrtar ligjor: Është e njëjta procedurë me kërkesën paraprake që është zhvilluar vitin e kaluar sipas kërkesës së kësaj kompanie me seli në Pejë parcelën e ka të bashkuar por rrugën e ka më mes të parcelës dhe ka kërkuar për arsye të procedurave të cilat i ka

ka kërkuar me bërë bashkimin e parcelave të veta dhe rruga siç është me u bartë. Vendimi në asamble është marrë 02/143 më datë: 24.05.2025, nga pjesa e parcelës 150/5 zona kadastrale Llazicë i bie dhe 1 ari e 91m² i bashkangjitet pronës së Komunës. pjesa e njëjt siq vlerësohet prej ministrisë i kompenzohet palës, pjesa private i bashkangjitet rrugës ndërsa pjesa publike i bashkangjitet kompanisë. kompania DHF është kompani e cila mirret me shitblerjen e naftës në teren gjendja faktike është ndryshe ndërsa në letra është ndryshe sepse i kanë mbetur pjesët e parcelave të ndara. Tani po kërkon me bërë bashkimin e parcelave dhe pjesën e vetë me ja liru rrugës, ndërsa rruga e cila ja ndanë parcelat me i kalu në pronësi. As nuk i shtohet as nuk i hiqet asnjë milimeter. Prej pjesës private kalon në publike dhe prej pjesës publike në private. Vendimi përfundimtar mirret prap nga ju dhe pas vendimit përfundimtar lëshohet kontrata për këmbim të pronës. Vendimi është marrë dhe ka qenë i ligjshëm vetëm se ministria ka thënë që për arsye se ngastrat i ka pasur në hipotekë, dhe thotë së pari të largohet nga hipoteka pastaj të bëhet këmbimi. Për këtë arsye pala e ka largu ngastrën prej hipotekës prona është e lirë dhe tani mundemi me hi në proces të këmbimit. Vlerësimin e bën ministria e financave, vendimin e merrni ju, vendimin përfundimtar prap keni me marrë ju dhe pas vlerësimit të ministris bëhet këmbimi i pronës. Vitin e kaluar nuk është kryer për arsye se është kthyer për rishqyrtim në kohë të zgjedhjeve.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Kur ka kësia kërkesa është mirë me i shti në rend të ditës me koh në mënyr që me na u dhënë koha e mjaftueshme me shqyrtu, sepse kur po na vjenë në mbledhje ne po i kemi pikat e tjera nuk po kemi kohë me shqyrtu.

Muharrem Morina-Zyrtar ligjor: Ka qenë në KPF por është lëshim i joni teknik.

Halil Morina (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Meqë kemi të bëjmë me interes të dy anshëm dhe të Komunës dhe të palës, dhe nuk është vendimi jonë përfundimtar ne i hapim rrugë këti këmbimi e pastaj procedurat siq janë prej ministrisë së financave vendimi përfundimtar ka me ardhë prapë këtu, është mirë që të i japim epilogë dhe të votojmë pro kësaj kërkesë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Bashkim Krasniqi!

Bashkim Krasniqi (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Ashtu siç e sqarojë dhe Muharremi është një rrugë me skic që e ndanë pronën private dhe momentalisht është e pa shfrytëzueshme nga qytetarët dhe pala ka kërkuar me bërë zgjidhje këtë rrugë me zhvendos prap në pronën private të tij në sipërfaqen siq vlerësohet nga Ministria në mënyr që ai me mujt me shfrytëzu pronën e vetë pa ndonjë pengesë, dhe njerëzve tjerë me ju dhënë qasje që ajo rrugë me u bërë rrugë publike. Unë jam me kalu kjo kërkesë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Kush është për aprovim të kërkesës 01/362 datë: 27.03.2025?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 9

Me 15 vota për, 0-Kundër, 9-Abstenime kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Te pika të ndryshme a dëshiron ta marrë fjalën ndokush?

Urdhëro, Hafir Rexha!

Hafir Rexha (anëtarë nga Nisma Socialdemokrate): Te pika të ndryshme të kamë thënë dhe në mbledhjen e parë ende nuk na ke paisë me lllaptopë po kemi vështirësi. përdori mekanizmat e institucioneve me na paisë neve me mjete të konkretizuara në këtë rast me lllaptopë. Kushtet nuk janë të mira, ftoftë salla nuk është ngrohë si duhet nuk na sjellët ujë. Kuvendi ka buxhetë të paktën nga një shishe ujë me na sjellë. Kryesus afatin e ke deri në shtator me na ndreq sallën përndryshe nuk ta falim.

Fitim Shala (anëtarë nga LDK): Meqenëse jemi dëshmitar të diskutimit të grupit shoqëror për temën dhe ekspozitën të masakrave në Kosovë dhe tentimi i shtrembërimit të fakteve me apo pa dashje nga persona të caktuar, dhe është 27 vjetori i masakrës së Burimit kërkoj nga ekzekutivi që 28 vjetori i kësaj maskare të mos i gjejë varrezat në atë gjendje siç janë, letë shtrihet dora e ekzekutivit në atë pjesë. Gjithëashtu meqë e kam parë në agjend që neser nuk kemi seancë përkujtimore kërkoj që ta mbajmë një minut heshtje për të gjithë martirët e rënë në masakrën e Burimit dhe gjitha masakrat në Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Urdhëro, Enver Hoti!

Enver Hoti (anëtarë nga AAK): Dola të kërkojë falje për vonesë gjatë kësaj mbledhje sepse kamë gabuar orarin.

Lidhur me dhënien në shfrytëzim të pronave publike vota e AAK-së është kundër dhe të paktën Kryesus mbas 4 viteve mos thuaj e ka bërë qeveria Nisma sepse e keni bërë dhe ju. Nuk është në interes publik është kundër, unë mendoj që duhet të shqyrtohen në të ardhmen dhe të ndalohen, as nuk ka të drejtë Kuvendi dhe as nuk kanë të drejtë në Ministri të sponzorizojnë dhe të investojnë projekte të caktuara.

Veton Zogaj (anëtarë nga LVV): Vetëm një sqarim shtesë sa i përket lllaptopëve ish anëtarët e grupit tonë i kanë dorzuar Agnesa e ka dorzuar në zyre ndërsa Arbnora ja ka dorëzuar Vlerës nëse nuk ka ndonjë shkelje procedurale. Ndërsa sa i përket Valon Krasniqi nëse nuk e ka dorëzuar ende është mirë me thirrë personalisht sepse nuk kamë kontakt.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: A ka dikush tjetër për pikën Të ndryshme? Urdhëro, Imran Xhyliqi!

Imran Xhyliqi (anëtarë nga PDK): Unë e kamë një shqetësim në shkollën e fshatit Marali ku aty është zgjedhur një Drejtor i ri i shkollës dhe i urojë suksese, ai njëkohësisht është duke e mbajtur edhe lëndën e Matematikës sepse nuk ka arsimtar për atë lënd. Dua tja bëjë pyetjen Drejtoreshës së Arsimit përse një arsimtar e ushtron detyrën e Drejtorit dhe të Arsimtarit të matematikës?

Një arsimtare e mësimit klasor është dalë në pension, tash një muaj e gjysmë ose dy muaj ende nuk është zëvendësuar, nxënësit majn mësim kush është më i lirë i jep mësim përse duhet me u kriju kjo? A duhet me prit deri ta merr librezën e portokalltë ndonjë i partis? Ka shumë persona që mundën me kry këtë punë për mësim klasor. meqenëse nuk është Drejtoresha këtu mundet me na dhënë përgjigje në mbledhjen e ardhëshme.

Kryesuesi i Kuvendit- Fatmir Ademaj: Qështja që e ngriti Vetoni që një ish asambleiste ja ka dorëzu asambleistes, kështu kamë parë raste te Nisma por nuk e kemi informaten që llaptopi është dorëzuar derisa nuk bëhet një mekanizëm i sakt në zyrën e Kryesusit që është kry ky formalitet i dorëzimit, nuk ka lidhje leta marrin dhe najkush që janë familjar nëkëtë rast siq është Genta me Urimin.

Qështjen e sallës Hafir ne e kemi votuar në buxhet kjo është qështje e procedurave dhe zyrës së Kryetarit, mekanizmave të prokurorimit për me fillu procedurën.

Enver në aspektin politik kemi shumë tema me i diskutu sot dikush është në pozitë nesor në opozitë dhe të premtojë publikisht që sa herë të jam në opozitë listen e pronave do ta votojë gjithmonë sepse është obligim ligjor i një asambleisti.


Te qështja e Fitimit një deklaratë do ta lëshojmë si Kuvend, ju ftojë për një minut heshtje për nderim për gjithë civilët e rënë në Komunën e Malishevës.

Nderime!

Me kaqë e mbylli senacën e dytë të rregullt shihemi në seancën e radhës.

Mbaroi në ora: 12:10.

Procesmbajtësja
Argenitë Thaçi



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Ademaj

